

**Raporti i Komisionit për shqyrtimin e ankesave në lidhje me Konkursin për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të UP - së me Nr. Prot.: 1/909, dt 1.8.2023**

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, i emëruar me vendim të Këshillit të Fakultetit të Filologjisë, me Nr.Prot.: 01/3499, dt 8.9.2023, është mbledhur më 9.10.2023 për ta shqyrtuar ankesën e kandidatës Valë Rudari (nr. prot. 03/4379, dt. 2.10.2023). Komisioni për ankesa gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë ka marrë parasysh dosjen me të cilat kandidatja ka aplikuar për angazhim në cilësinë e bashkëpunëtores të jashtëm për ushtrime në pozitën nr. III.17, III. 21 dhe III.22 dhe raportin e Komisionit vlerësues për pozitën në fjalë.

Parashtruesja e ankesës në ankesën e saj pretendon që komisioni vlerësues me rastin e propozimit të kandidatës III.17, nuk kanë vlerësuar drejt përvojën e punës, në raportin e komisionit vlerësues me Nr. Prot.: 03/4068, dt 22.9.2023 tek lista tabelore e cila trajton përvojën e punës në fushën përkatëse si kandidatja e përzgjedhur si dhe parashtruesja e ankesës znj. Rudari e kanë të shënuar me JO, pasi që në pikën 4.1, të nenit të 7-të të Rregullores së procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prot. 01/95, dt.24.06.2021, përvojë e punës në fushën përkatëse konsiderohet angazhimi në UP ose në ndonjë institucion të akredituar të arsimit të lartë.

Në ankesën për pozitë III.22, komisioni i ankesave ka rishikuar dokumentacionin e aplikimit të kandidatës Valë Rudari. Në dokumentacionin e përmendur parashtruesja e ankesës, znj. Rudari, sipas pikës V të Konkursit me Nr. Prot.: 1/909, dt 1.8.2023, ka dorëzuar diplomën e studimeve baçelor me Nr. 3431 si dhe certifikatën e notave të studimeve baçelor me Nr. Prot.: 04/3225, dt 16/08/2023, nga të cilat vërtetohet se e kandidatja Rudari në studimet themelore e ka notën mesatare: 7.58.

Rregullorja e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prot. 01/95, dt.24.06.2021, në neni 7, pika 3.2 e paragrafit 3 parasheh që kushtet që kandidatët duhet të kenë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.

Prandaj komisioni për shqyrtimin e ankesave konsideron se ankesa e kandidatës Valë Rudari është e pabazuar.

Kandidatja Valë Rudari ka parashtruar ankesë edhe në pozitën III.21, për të cilën nuk ka aplikuar fare, prandaj komisioni i ankesave konsideron që ankesa është e pabazuar.

Prishtinë, më 9.10.2023

Komisioni:

1. Prof.ass.dr. Remzije Shahini Hoxhaj – kryetare
2. Prof.dr. Nuran Muhaxheri – anëtare
3. Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi – anëtar

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I FILOLOGJISË  
PRISHTINË

Pranuar më:	09/10/2023		
Nr. ore	numar	Shtoiçë	Vlerë
03	4513	3	/